



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/244
Datë: 10.01.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 14, paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 100,000€ (njëqind mijë euro), për mbulimin e shpenzimeve për mbrojtjen juridike - mbështetje financiare për familjarët e veprimtarit Enver Hadri, përkatësisht mbulimin e shpenzimeve financiare për procesin gjyqësor, i cili ka filluar në Gjykatën Penale në Bruksel, në çështjen penale kundër të akuzuarve për vrasjen e aktivistit të njohur të çështjes së Kosovës, z. Enver Hadri, i vrarë në Belgjikë në vitin 1990.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232 nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" dhe transferohen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, në nën-programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Thesari që të realizojë transferin e mjeteve sipas pikës 1. të këtij vendimi në llogarinë bankare të caktuar nga familja e veprimtarit Enver Hadri, të siguruar nga Ministria e Drejtësisë.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Drejtësisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë